

Transmetuar më 13.05.2020

Titulli: **Beteja për ushqimin më e fuqishme se frika nga COVID-19**

["http://play.mrt.com.mk/play/40044?fbclid=IwAR0qHfT0aHf3IMaD_bvW5gj3_x9-GcJyeUx4eU9QasInsXvAfDVxyB5L1Cw"](http://play.mrt.com.mk/play/40044?fbclid=IwAR0qHfT0aHf3IMaD_bvW5gj3_x9-GcJyeUx4eU9QasInsXvAfDVxyB5L1Cw) HYPERLINK

Nuk ka televizor dhe nuk ka dëgjuar për Covid-19. Roza nga Shuto Orizarja nuk ka frikë nga virusi tinëzar që pa mëshirë po përhapet nëpër botë. Çdo lajm e merr nga bija e saj.

Sinkron Roza:

“Nuk kam dëgjuar për asnjë virus”.

“Po a keni televizor?”

“Jo, nuk kam televizor.”

Lajmet vonojnë edhe për Arifin. Ai di për sëmundjen, mirëpo nuk di se ka lehtësime për karantinën e detyrueshme.

Sinkron Arifi

“E di se ka orë policore?”

“A e di prej kur fillon?”

“Prej orës katër!”

Përfaqësuesit e qeverisë çdo ditë lajmërojnë për statistikën e reja për Covid-19. I përsërisin edhe masat e detyrueshme për mbrojtje nga sëmundja. Mirëpo, prej vendit ku paraqiten, prej qendrës, deri në Shuto Orizare ka saktësisht pesë kilometra. Dikund rrugës, lajmet humbin dhe nuk arrijnë deri te këta njerëz që jetojnë buzë varfërisë. Shuto Orizarja është pjesë e kryeqytetit, por grupet e marginalizuara nuk kanë kushte t’i dëgjojnë rekomandimet për të mundur edhe t’i respektojnë.

Prej Organizatës Joqeveritare “Nisma e grave të Shuto Orizares”, thonë se pjesa dërmuese e këtyre njerëzve nuk dinë ku të drejtohen kur u shfaqet çfarëdo simptome.

Deklaratë: Salija Beqir Halimi- “Nisma e grave të Shuto Orizares”

“Pasi pandemia përfshiu vendin tonë, ne zbatuam një studim ku përfshimë 196 gra nga Shuto Orizares. Vetëm 14 për qind e tyre janë të njoftuara me lajmet nëse kanë simptome ku të drejtohen dhe si është gjithë procedura për shërimin e mëtutjeshëm.”

Nga komuna thonë se bëjnë çfarë mundën. Kanë ndarë maska dhe doreza, u kanë dhënë edhe fletushka informative.

Deklaratë: Fatima Osmanovska – Kryetare e Këshillit të Komunës Shuto Orizare

“Angazhuam vullnetarë shtesë, roje komunale që janë në terren dhe të cilët shpërndajnë informata, mirëpo edhe ndajnë maska mbrojtëse për popullësinë, do të thotë punojmë për të parandaluar sëmundjen.”

Por beteja kryesore e pushtetit lokal është të mos ketë njerëz të uritur. Fatima, bashkë me një grua tjetër, kuzhinën e çerdhës për fëmijë e kanë hapur çdo ditë për të gatuar racione për fëmijët e rrugës. Furnizimet i sigurojnë prej komunës bashkë me vullnetarët nga Shutka.

Dialog i gazetares me Shukrien dhe Sanelën:

“Çfarë keni gatuar diçka të shijshme sot?”

“Kjo është musakë. E ngrohtë është, e gatuar për fëmijët nga rruga”

“Sa pako ka gjithsej?”

“Rreth 60”

“Kjo është bukë e ngrohtë?”

“Po, e ngrohtë është.”

“Sa copa dalin prej saj?”

“Po, rreth 70”.

“Aha, do të thotë prej saj kërkohet më shumë.”

Almiri 12 vjeçarë i pari do ta shijojë racionin e shijshëm.

Dialog i gazetares me Almirin:

“Çfarë ka brenda, e din?”

“Musakë!”

“Ke ngrënë diçka të ngjashme?”

“Po!”

Pakot e tjera do të shpërndahen nëpër rrugicat e afërta ku dhjetëra fëmijë të uritur presin sirenën e makinës së Fatimës.

(Atmosferë)

Këtu distanca matet sipas gjatësisë së dorës – mjafton të kapet ushqimi i shijshëm. Nuk ka doreza dhe maska sepse ato gjithsesi nuk janë të nevojshme kur duhet të hahet.

Stend up:

“Shuta Orizarja ka afër 40 mijë banorë. Dy mijë familjeve të këtushme u nevojitet ndihmë e domosdoshme. Në Shuta Orizare nuk ka pikë për testim nga Covid-19. Më e afërta është në Çair, ndërsa deri atje vështirë arrihet. Sipas informatave të Komunës, pozitiv me virusin janë 12 persona. Nuk dihet sa kanë vdekur dhe sa aktualisht janë aktiv.”